

**RAPORTET BILATERALE**  
**NDËRMJETKOSOVËSDHESERBISË**  
**RRETH**  
***SEKTORIT TË ENERGJISË***

Tetor 2019

Mbështetur nga:



Norwegian Embassy



Sheshi Nënë Terezë, Hyrja I · 59A · Nr. 10  
Prishtinë, 10000  
Republika e Kosovës  
T/F: +383 38 746 206  
**E-mail:** ridea.institute@gmail.com  
**Website:** www.ridea-ks.org

**STUDIM**

**MBI**

**RAPORTET BILATERALE NDËRMJET KOSOVËS DHE**  
**SERBISË RRETH SEKTORIT TË ENERGIJË**

Tetor 2019

# STUDIM MBI: RAPORTET BILATERALE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË RRETH SEKTORIT TË ENERGIJË

Ky studim u mbështet nga:



Norwegian Embassy

**Deklaratë mohimi:** Pikëpamjet dhe analiza në këtë raport janë vetëm të RIDEA-s dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

**Autor:** Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA)

Tetor 2019

## Përmbajtja

Shkurtesat .....	i
<b>Hyrje .....</b>	<b>1</b>
<b>Traktati mbi Komunitetin e Energjisë dhe Mosmarrëveshja lidhur me Energjinë në mes të KOSTT dhe EMS.....</b>	<b>2</b>
<b>Dialogu i Brukselit dhe Mos-marrëveshja lidhur me Energjinë në mes të KOSTT dhe EMS.....</b>	<b>15</b>
<b>Humbjet Financiare të KOSTT që Rrjedhin nga Mospagesa e Faturave të Energjisë Elektrike në Pjesën Veriore të Kosovës .....</b>	<b>21</b>
<b>Dëmi Kolateral që Rrjedh nga Shkelja e Traktatit mbi Komunitetin e Energjisë nga ana e Serbisë .....</b>	<b>23</b>
<b>Përfundimet.....</b>	<b>25</b>
<b>Rekomandimet.....</b>	<b>29</b>

## Shkurtesat

<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>CE RG</b>	Grupi Rajonal i Evropës Kontinentale
<b>CGES</b>	Operatori i Sistemit dhe Transmisionit të Malit të Zi
<b>EIC</b>	Kodi Identifikues Energjetik
<b>EMS</b>	Operatori i Sistemit dhe Transmisionit të Serbisë
<b>EnC</b>	Komuniteti i Energjisë
<b>EnCAC</b>	Këshilli i Komunitetit të Energjisë
<b>EnCS</b>	Sekretariati i Komunitetit të Energjisë
<b>EnCT</b>	Traktati i Komunitetit të Energjisë
<b>ENTSO-E</b>	Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit
<b>EPS</b>	Ndërmrrja e Energjisë Elektrike e Serbisë
<b>ITC</b>	Kompenzimi ndër-Operatorë i Sistemit të Transmisionis
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>KEDS</b>	Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike
<b>KEK</b>	Korporata Energjetike e Kosovës
<b>KOSTT</b>	Operatori Kosovar i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut
<b>MC-EnC</b>	Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë
<b>MEPSO</b>	Transmisioni i Energjisë Elektrike dhe Menaxhimi i Sistemit të Energjisë së Malit të Zi
<b>MSA</b>	Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>OST</b>	Operator i Sistemit të Transmisionit, Shqipëri

<b>TSO</b>	Operatori i Sistemit të Transmisionit
<b>UCTE</b>	Unioni për Koordinimin e Transmisionit të Energjisë Elektrike
<b>UNMIK</b>	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
<b>ZRRE</b>	Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës

## Hyrje

1. Në këtë punim, qëllimi është që të analizohen në mënyrë kritike raportet bilaterale në mes të Kosovës dhe Serbisë lidhur me energjinë në kuadër të Traktatit mbi Komunitetin e Energjisë dhe të Dialogut të Brukselit, si dhe në bazë të kësaj të nxirren rekomandime relevante.
  
2. Objektivat e këtij punimi janë:
  - i) Rishikimi kritik i faktorëve historik mbi raportet bilaterale mbi energjinë në mes të Kosovës dhe Serbisë;
  - ii) Rishikimi kritik i zbatimit, apo mungesës së zbatimit, të marrëveshjeve të arritura në mes të Kosovës dhe Serbisë lidhur me energjinë në kuadër të Traktatit mbi Komunitetin e Energjisë;
  - iii) Rishikimi kritik i zbatimit, apo mungesës së zbatimit, të marrëveshjeve të arritura në mes të Kosovës dhe Serbisë lidhur me energjinë në kuadër të Dialogut të Brukselit;
  - iv) Vlerësimi i humbjeve monetare dhe të hyrave monetare të humbura nga ana e Kosovës që rrjedhin nga shkeljet nga ana e Serbisë të marrëveshjeve të ndryshme lidhur me energjinë të arritura në mes të Kosovës dhe Serbisë; dhe
  - v) Propozimi i rekomandimeve relevante.

Struktura e këtij punimi bazohet në strukturën e objektivave të specifikuar më lartë.

## Traktati mbi Komunitetin e Energjisë dhe Mosmarrëveshja lidhur me Energjinë në mes të KOSTT dhe EMS

1. Raportet bilaterale mbi energjinë, duke përfshirë këtu edhe energjinë në tranzit, në mes të KOSTT dhe EMS janë themeluar në vitin 2000 dhe janë qeverisur përmes Marrëveshjes së Përkohshme mbi Shkëmbimin e Energjisë të vitit 2000<sup>1</sup> dhe Marrëveshjes së Përkohshme Teknike të vitit 2001.<sup>2</sup> Këto dy marrëveshje u nënshkruan në mes të Departamentit të Ndërmarrjeve Publike të UNMIK në emër të KOSTT (atëbotë, para procesit të ndarjes, Korporata Energjetike e Kosovës) dhe Ministria e Energjisë dhe Minierave e Serbisë në emër të EMS (atëbotë, para procesit të ndarjes, Industria e Energjisë Elektrike e Serbisë). Sipas Mendimit të Arsyetuar të EnCS, edhe pse nuk u respektuan, këto dy marrëveshje janë ligjërish të obligueshme edhe për KOSTT edhe EMS, meqë ato (i) janë nënshkruar nga Palët Kotraktuese të tyre dhe (ii) asnjëherë nuk janë shkëputur/anuluar. Sipas Pikës 1.4.2 të Marrëveshjes së Përkohshme mbi Shkëmbimin e Energjisë së vitit 2000 "*pala për të cilën realizohet tranziti i energjisë elektrike do t'ia rimburojë shpenzimet e tranzitit palës tjetër, në të mira ose në bazë financiare*".<sup>34</sup>
2. Në vitin 2004, sipas Nenit 3 të Rregullores 1228/2003, disa marrëveshje multilaterale për kompenzim (tani e tutje ITC marrëveshje) u nënshkruan me qëllim të themelimit të mekanizmit për menaxhimin e kompenzimit të shpenzimeve për energjinë në transit.<sup>5</sup> Me hyrjen në fuqi të këtyre marrëveshjeve, në vitin 2004, EMS

---

<sup>1</sup> UNMIK (2000), 'Marrëveshja e Përkohshme për Shkëmbimin e Energjisë. Në Kërkesën e Arsyetuar të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë'. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>2</sup> UNMIK (2001), 'Marrëveshja e Përkohshme Teknike. Në Kërkesën e Arsyetuar të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë'. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>3</sup> Kompenzimi në të mira duhet të llogaritet dhe paguhet në bazë të rregulloreve të EKC.

<sup>4</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2011), 'Mendim i Arsyetuar lidhur me Rastin ECS 03/08, i datës 7 tetor 2011'. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>5</sup>Parlamenti Evropian (2009), 'Rregullorja Nr 1288/2003'. Në dispozicion në: <https://www.ceer.eu/documents/104400/-/-/70c72407-a9ce-4b4e-1eec-164225c8dd06> [Qasur më: 6 shtator 2019].



– nënshkruese e këtyre marrëveshjeve, ndaloi së rimbursuari KOSTT-in për shpenzimet (*lidhur me humbjet apo infrastrukturën*) që rezultojnë nga tranziti i energjisë që e kishte origjinën ose përfundonte në rrjetin e EMS, nëpërmjet rrjetit të Kosovës. Sipas kësaj, EMS ndaloi së transferuari në KOSTT mjetet që EMS i pranonte për alokimin e kapacitetit të transmisionit në tri linjat e interkoneksionit të Palëve Kontraktuese fqinje me rrjetin e operuar nga KOSTT, gjegjësisht, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi. Në mars të vitit 2011, një ITC marrëveshje e re u nënshkrua në mes të ENTSO-E dhe 39 Operatorëve të Sistemit të Transmisionit (tani e tutje OST), duke përfshirë këtu edhe EMS, por duke përjashtuar KOSTT-in. Sipas kësaj marrëveshje, *“EMS është listuar edhe si palë ITC edhe si Shtet/Bllok Kontrolli për Serbinë, por pa iu referuar në mënyrë specifike territorit të Kosovës”*.<sup>6</sup> Gjithashtu, sipas Rregullores (EU) Nr 838/2010, OST që operojnë në territoret e qeverisura nga Ligji i Komunitetit të Energjisë kanë të drejtë të marrin pjesë në mekanizmin ITC. Rrjedhimisht, KOSTT, i cili operon si OST në territorin e Kosovës, ka të drejtë të marrë pjesë në mekanizmin ITC dhe të kompenzohet për tranzitin e energjisë.<sup>7</sup>

3. Sipas qeverisë së Kosovës, shkeljet nga ana e Serbisë të këtyre marrëveshjeve ia kanë shkaktuar OST kosovare një dëm financiar prej rreth 15 milionë euro për çdo vit.<sup>8</sup> Kjo jep një vlerë totale të dëmit financiar – vlerë totale të borxhit financiar që OST serbe ia ka OST kosovare – prej rreth 225 milion Euro për periudhën 2004-2019.

---

<sup>6</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2011), 'Mendim i Arsytuar lidhur me Rastin ECS 03/08, i datës 7 tetor 2011' Pikat 17 dhe 18. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>7</sup> Komisioni Evropian (2010), 'Rregullorja (EU) Nr 838/2010'. Në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2010:250:0005:0011:EN:PDF> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>8</sup> Ministria e Energjisë dhe Minierave (2009), 'Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës'. Në dispozicion në: [http://www.mei-ks.net/repository/docs/ANNEX\\_12 - Kosovo Energy Strategy 2009-2018.pdf](http://www.mei-ks.net/repository/docs/ANNEX_12_-_Kosovo_Energy_Strategy_2009-2018.pdf) [Qasur më: 6 shtator 2019].

4. Në vitin 2006, UNMIK në emër të Kosovës nënshkroi Traktatin e Komunitetit të Energjisë (tani e tutje EnCT).<sup>9</sup> Si rezultat i kësaj, Kosova është anëtare e EnCT që nga viti 2006. UNMIK si Palë Kontraktuese e EnCT ka caktuar KOSTT si të vetmin OST në territorin e Kosovës në përputhje me Nenin 8 të Direktivës 2003/54/EC.<sup>1011</sup>
  
5. Sipas Pikës 1.3 të Marrëveshjes së Përkohshme Teknike të vitit 2001, KOSTT ka marrë obligimin *“për të paguar EMS për ofrimin e shërbimeve, duke përfshirë këtu prokurimin e rregullativës sekondare të KOSTT nga ana e ndërmarrjes publike serbe Elektroprivreda Serbia (EPS)”*.<sup>12</sup> Në prill të vitit 2007, KOSTT ndërpreu pagesat ndaj EPS për ofrimin e këtyre shërbimeve.
  
6. Më 6 gusht 2008 – pas dështimit të gjetjes së zgjidhjes për mosmarrëveshjet mbi energjinë përmes negociatave bilaterale dhe negociatave të ndihmuara nga ETSO dhe nga Komisioni Evropian - KOSTT ngriti padi kundër Serbisë në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë (EnCS). Si pasojë, EnCS ka hapur **Rastin ECS-3/08**. Lënda e kësaj padie është *“se Serbia përmes veprimeve të ndërmarra nga kompania publike EMS dështon të respektojë Nenin 9 të Traktatit të ndërlidhur me Artikullin 3 dhe 6 të Rregullores 1228/2003 mbi qasjen në rrjetin për shkëmbimin ndërkufitar të energjisë (“Rregullorja 1228/2003”), duke e penguar/pamundësuar pjesëmarrjen e KOSTT në marrëveshjet për kompensim ndër-OST (“ITC marrëveshje”) dhe në alokimin e kapacitetit të transmisionit në tri linjat e interkoneksionit të Palëve*

---

<sup>9</sup> Duke filluar nga viti 2019, Kosovës do të jetë e obliguar të raportojë në bazë të Shtojcës VIII.B të Direktivës 2001/80/EC siç është amendamentuar me Vendimin 2013/05/MC-EnC.

<sup>10</sup>Duhet të përmendet se ligjet e Kosovës që aplikohen në rastin e KOSTT “transpozojnë *acquis communautaire* të EnC mbi OST që përmban Direktiven 2003/54/EC dhe Rregulloren (EC) 1228/2003.

<sup>11</sup> Parlamenti Evropian (2008). ‘Direktiva Nr 2003/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 qershorit 2003. Në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CONSLEG:2003L0054:20080123:EN:PDF> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>12</sup> UNMIK (2001), ‘Marrëveshja e Përkohshme Teknike. Në Kërkesën e Arsyetuar të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë’. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

*Kontraktuese fqinje me Kosovën, gjegjësisht, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi*.<sup>13</sup>

7. Në Letrën Hyrëse, të datës 17 shtator 2010, EnCS ofroi argumente për përfundimet e tij preliminare se: i) dështimi i EMS për të kompenzuar KOSTT për shpenzimet që i janë krijuar nga tranziti i energjisë që e ka origjinën në ose përfundon në rrjetin e EMS përmes rrjetit të operuar nga KOSTT është shkelje e Nenit 3 të Rregullores 1228/2003 dhe ii) shfrytëzimi nga ana e EMS i të hyrave të realizuara nga alokimi i kapacitetit të transmisionit në tri linjat e interkoneksionit të Palëve Kontraktuese fqinje me Kosovën, gjegjësisht, të Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi paraqet shkelje të Nenit 6(6) të Rregullores 1228/2003.<sup>14</sup>
  
8. Pas përgjigjes së Serbisë lidhur me **Rastin ECS-3/08**, EnCS u tërhoq pjesërisht nga Kërkesa e Arsyetuar, e datës 31 maj 2016<sup>15</sup> dhe dorëzoi në MC-EnC verzionin e reviduar më datën 20 korrik 2016.<sup>16</sup> Rrjedhimisht, lënda në **Rastin ECS-3/08** u riformulua si në vijim “... shfrytëzimi nga ana e EMS i të hyrave të realizuara nga alokimi i kapacitetit të transmisionit në linjat e interkoneksionit...” të tre Palëve Kontraktuese në fjalë, fqinje me Kosovën.<sup>17</sup> Prandaj, lënda përmbante vetëm çështjen e shfrytëzimit nga ana e EMS të të hyrave të realizuara nga alokimi i kapacitetit të transmisionit në tri linjat e interkoneksionit fqinje me KOSTT. Çështja e alokimit të kapacitetit të transmisionit u përjashtua dhe u trajtua nga EnCS në një rast tjetër ligjor kundër Serbisë.

---

<sup>13</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2016), ‘Kërkesa e Arsyetuar e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë’. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>14</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2011), ‘Mendim i Arsyetuar lidhur me Rastin ECS 03/08, i datës 7 tetor 2011’ Pikat 17 dhe 18. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>15</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2016), ‘Kërkesa e Arsyetuar e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, e datës 31 maj 2016’. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 gusht 2019]

<sup>16</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2016), ‘Kërkesa e Arsyetuar e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, e datës 20 korrik 2016’. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>17</sup> Po aty.

9. Duke qenë anëtar i EnCT, KOSTT si vetmi operator sistemi dhe transmisioni (OST) i caktuar dhe i licencuar për territorin e Kosovës, ka obligim që të vepronë në përputhje të plotë me EnC *acquis communautaire*, siç parashihet me Nenin 10 të EnCT, *“Secila Palë Kontraktuese duhet të zbatojë *acquis communautaire* mbi energjinë në përputhje me orarin kohor për zbatimin e atyre masave të caktuara në Shtojcën I”*.<sup>18</sup> Në këtë mënyrë, sipas Rregullores 1288/2003<sup>19</sup>, Neni 6, Paragrafët 1-5, KOSTT si OST ka, ndër të tjera, obligim ligjor që të menaxhojë problemet e kongestionit në një mënyrë jodiskriminuese në rrjetin e tij, të alokojë kapacitet të interkoneksionit për pjesëmarrësit e tregut, të informojë pjesëmarrësit e tregut për planet e alokimit të kapacitetit, si dhe të sigurojë shfrytëzimin e kapacitetit maksimal të linjave të interkoneksionit. Po ashtu, siç thuhet në Rregulloren 1288/2003, Neni 3, KOSTT duhet, ndër të tjera, të kompenzohet për shpenzimet e bëra për alokimin e kapacitetit në rrjetin e tij nga ana e OST në rrjetin e të cilave energjia ose e ka origjinën ose përfundon.

10. Mirëpo, në Pikën 79 të Kërkesës së Arsyetuar, të datës 20 korrik 2016, EnCS shpjegon që për shkak se KOSTT nuk është pranuar zyrtarisht si një zonë kontrolli (gjë që varet nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Lidhjes me ENTSO-E), EMS realizon manaxhimin e kongestionit dhe alokimin e kapacitetit në tri linjat e interkoneksionit në mes të Kosovës dhe Palëve Kontraktuese në fjalë, gjegjësisht, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi.<sup>20</sup> Si pasojë, këto tri Palë Kontraktuese kanë kontrata me EMS dhe jo me KOSTT. Duke pas parasysh këtë situatë, EnCS nuk konsideron se Serbia ka dështuar të respektojë ligjin e EnC lidhur me menaxhimin e kongestionit dhe alokimin e kapacitetit, por ka dështuar ta

---

<sup>18</sup> Komuniteti i Energjisë (2006), ‘Traktati i Komunitetit të Energjisë’. Në dispozicion në: <https://ec.europa.eu/transparency/regdoc/rep/1/2005/EN/1-2005-435-EN-F1-1.Pdf> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>19</sup> Rregullorja (EC) Nr 1288/2003 është zëvendësuar me Rregulloren Nr 714/2009. Rregullorja Nr 714/2009 më vonë është përfshirë në *acquis communautaire* të EnC përmes Vendimit 2011/02/MC-EnC të MC-EnC, të datës 6 tetor 2011 (Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, 2011).

<sup>20</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2016), ‘Kërkesa e Arsyetuar e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, e datës 20 korrik 2016’. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

respektojë të njëjtin lidhur me shfrytëzimin e të hyrave nga kongjestioni (siç do të elaborohet më poshtë).

**11.** Megjithatë, duhet të ritheksohet se, siç është qartësuar në Pikën 26 të Kërkesës së Arsyetuar, EMS nuk është mandatuar të realizojë menaxhimin e kongjestionit apo alokimin e kapacitetit në tri linjat e interkoneksionit në bazë të asnjërës nga marrëveshjet e mëparshme (Marrëveshjes së Përkohshme mbi Shkëmbimin e Energjisë, Marrëveshjes së Përkohshme Teknike dhe Marrëveshjes mbi bllokun e kontrollit SMM) në mes të Kosovës dhe Serbisë (dhe/apo KOSTT dhe EMS) që qeverisin raportet e tyre në fushën e energjisë.<sup>21</sup>

**12.** Sipas Nenit 6(6) të Rregullores 1228/2003, *“Çfarëdo të hyrash që rrjedhin nga alokimi i interkoneksionit duhet të shfrytëzohen për njërin apo disa nga qëllimet në vijim: (a) garantimi i disponimit/pasjes aktuale të kapacitetit të alokuar; (b) investimet në rrjet për mirëmbajtjen apo rritjen e kapaciteteve të interkoneksionit; (c) si një e hyrë që duhet të merret parasysh nga autoritetet rregullative gjatë miratimit të metodologjisë për kalkulimin e tarifave të rrjetit dhe/ose gjatë vlerësimit, nëse tarifat duhet të ndryshohen”*. Shfrytëzimi i të hyrave që rrjedhë nga alokimi i kapacitetit të interkoneksionit siç rregullohet me Nenin 6(6) të Rregullores 1228/2003 është specifikuar në më shumë detaje në Nenin 16(6) të Rregullores 714/2009.<sup>22</sup>

**13.** Deri më sot, EMS de facto është duke realizuar menaxhimin e kongjestionit dhe alokimin e kapacitetit në tri linjat e interkoneksionit me Palët Kontraktuese fqinje të Kosovës dhe ka nënshkruar kontrata me këto tri Palë. Si pasojë, EMS, por jo KOSTT, është duke mbledhur të hyrat nga kongjestioni, duke përfshirë këtu të hyrat e realizuara nga menaxhimi i kongjestionit dhe alokimi i kapacitetit në tri linjat e

---

<sup>21</sup> Po aty.

<sup>22</sup> Parlamenti Evropian (2009), ‘Rregullorja Nr 714/2009 e EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 korrikut 2009’. Në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2009:211:0015:0035:EN:PDF> [Qasur më: 6 shtator 2019].

interkoneksionit fqinje me rrjetin që operohet nga KOSTT.<sup>23</sup> Mbledhja e të hyrave të tilla nga ana e EMS konfirmohet edhe nga raportet e publikuara nga EMS, tri OST, autoriteti rregullativ i Serbisë, si dhe nga raportet e publikuara nga Ministria përkatëse e Serbisë. Gjithashtu, prova për këtë janë ofruar edhe në përgjigjen e Ministrisë përkatëse të Serbisë ndaj Letrës Hyrëse të EnCS, ku Ministria pretendon se ajo është duke respektuar Nenin 6(6) të Rregullores 1288/2003.<sup>24</sup>

**14.** Mirëpo, EnCS e kundërshton konkludimin e Ministrisë serbe lidhur me respektimin e Nenit 6(6) të Rregullores 1288/2003. *“Shfrytëzimet që janë shënuar nga ana e Ministrisë nuk janë në përputhje të plotë me ato që janë listuar në Nenin 6(6) të Rregullores 1228/2003”.*<sup>25</sup>

- a. Shfrytëzimi nuk është në përputhje me Nenin 6(6)(a), ngase EMS *“as nuk i ka shënuar/përcaktuar të hyrat nga alokimi i kapacitetit në linjat e interkoneksionit në fjalë, as nuk i ka shfrytëzuar ato në mënyrë specifike për të garantuar specifikisht disponimin/pasjen e kapacitetit të alokimit në këto tri linja të interkoneksionit...”*.
- b. Shfrytëzimi nuk është në përputhje me Nenin 6(6)(a), ngase, në bazë të provave në dispozicion, EMS nuk ka investuar në mirëmbajtjen apo ndërtimin e infrastrukturës së re përbrenda rrjetit që operohet nga KOSTT. Vetëm KOSTT ka financuar të gjitha investimet në infrastrukturë, duke përfshirë këtu investimet në mirëmbajtjen e linjave të interkoneksionit me Palët Kontraktuese fqinje me rrjetin e Kosovës dhe investimet në ndërtimin e një linje të re të interkoneksionit me Shqipërinë. Për këtë qëllim, KOSTT

---

<sup>23</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2016), ‘Kërkesa e Arsytuar e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, e datës 20 korrik 2016’ Pikat 82 dhe 83. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>24</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2016), ‘Përgjigja e Republikës së Serbisë lidhur me Rastin ECS 03/08 kundër Serbisë’. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>25</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2016), ‘Kërkesa e Arsytuar e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, e datës 20 korrik 2016’. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

është përkrahur financiarisht nga donatorët, *“por jo nga të hyrat e realizuara nga alokimi i kapacitetit.”* Po ashtu, ndërtimi i linjës së re të interkoneksionit që lidhë Serbinë me Maqedoninë e Veriut nuk rritë kapacitetin e interkoneksionit në rrjetin e operuar nga KOSTT dhe *“nuk është specifikisht e destinuar për lehtësimin/shkarkimin e fyteve të ngushta në linjat e ngarkuara të interkoneksionit në fjalë”.*

- c. Shfrytëzimi nuk është në përputhje me Nenin 6(6)(a), ngase të hyrat nga kongjestionit nuk janë marrë për bazë nga autoriteti përkatës rregullativ i territorit të ndërlidhur me sistemet e transmisionit në fjalë, në këtë rast nga ZRRE e Kosovës, me qëllim të miratimit të metodologjive për kalkulimin e tarifave dhe për vlerësimin e nevojave për ndryshimin/zvogëlimin e tarifave që aplikohen nga OST që e operon këtë rrjet, gjegjësisht KOSTT). De fakto, autoriteti rregullativ i Serbisë është ai i cili ka marrë për bazë këto të hyra për ndryshimin e tarifave të aplikuara nga EMS për konsumatorët e lidhur me rrjetin e transmisionit të Serbisë. Kjo gjë është konfirmuar në Raportin e ECBR EWG mbi Referencimin/Benchmarkimin lidhur me Respektimin e Rregullores 1288/2003 dhe të Udhëzimeve për Menaxhimin e Kongjestionit, me ç’rast autoriteti rregullativ i Serbisë ka deklaruar se *“... të hyrat nga kongjestionit janë shfrytëzuar si të hyra që merren për bazë nga autoriteti rregullativ gjatë miratimit të metodologjisë për kalkulimin e tarifave të rrjetit dhe/ose për vlerësimin, nëse tarifat duhet të ndryshohen”.*
- d. Neni 6(6)(c) i Rregullores 1228/2003 bazohet në shpjegimin e arsyeshëm se të hyrat e realizuara nga kongjestionit, i cili operohet nga sistemi i transmisionit, duhet të shfrytëzohen për të zvogëluar tarifat e caktuara në bazë të kostos që rrjedhë nga operimi i po atij rrjeti të transmisionit, duke përfshirë këtu kostot që rrjedhin nga menaxhimin i kongjestionit dhe alokimi i kapacitetit në linjat e interkoneksionit. Sipas EnCS, Neni 6(6)(c) i Rregullores 1228/2003 *“presupozon ose (1) që operatori i sistemit të transmisionit është i njëjti entitet me entitetin që alokon kapacitetin e*

*interkoneksionit, ose (2) që kur kjo nuk është situata – për shembull kur kapaciteti i interkoneksionit alokohet nga një zyrë koordinuese – entiteti që alokon kapacitetin e interkoneksionit realizon kliringun ose transferin e të hyrave te operatori i rrjetit”.*<sup>26</sup> Duke pasur parasysh këtë dhe faktin që EMS (nuk e respekton ligjin e EnC, prandaj) jashtëligjshëm alokon kapacitetin e interkoneksionit në tri linjat e interkoneksionit fqinje me rrjetin e operuar nga KOSTT. Për të qenë në përputhje me Nenin 6(6)(c), EMS duhet t’ia transferojë KOSTT të hyrat e realizuara nga alokimi i kapacitetit në tri linjat e interkoneksionit në fjalë, si një nga opsionet e parapara me Nenin 6(6) të Rregullores 1228/2003.

**15.** Duke marrë për bazë të gjitha ato që u cekën më lartë, në Mendimin e Arsytuar, të datës 7 tetor 2011, EnCS erdhi në përfundimin se:

- a. *“Duke mos e kompenzuar KOSTT për shpenzimet që rrjedhin nga menaxhimi i rrjedhës ndërkufitare të energjisë elektrike në rrjetin e operuar nga KOSTT në rastet kur energjia elektrike ose e ka origjinën ose përfundon në sistemin e EMS, Republika e Serbisë, së cilës i ngarkohen veprimet dhe joveprimet e operatorit të saj shtetëror të sistemit të transmisionit, dështon të respektojë Nenin 3 të Rregullores 1228/2003.”*
- b. *“Duke mos shfrytëzuar të hyrat që realizohen nga alokimi i interkoneksionit në linjat e interkoneksionit me Shqipërinë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Malin e Zi për njërin apo disa nga qëllimet e specifikuara në Nenin 6(6) të Rregullores 1228/2003, Republika e Serbisë, së cilës i ngarkohen veprimet dhe joveprimet e operatorit të saj shtetëror të sistemit të transmisionit, dështon të respektojë Nenin 6 të Rregullores 1228/2003...”*

---

<sup>26</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2016), ‘Kërkesa e Arsytuar e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, e datës 20 korrik 2016’ Pika 95. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].



- c. *“Në përputhje me Nenin 13(2) të Rregullave të Procedurës për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjes, Republikës së Serbisë i kërkohet që të korrigojë shkeljet e identifikuar në Mendimin e Arsyetuar aktual, ose të paktën të bëjë angazhim të qartë dhe pa ekuivoke në këtë drejtim, brenda një afati kohor prej dy muajsh, d.m.th. deri më 7 dhjetor 2011 dhe ta njoftojë Sekretariatit për të gjithë hapat e ndërmarrë në atë drejtim”.*<sup>27</sup>

**16.** Në Përfundimet e Mendimit të Arsyetuar, të datës 7 tetor 2011, EnCS shpreh gatishmërinë e vet *“për të diskutuar mbi zgjidhjet e shpejta dhe praktike me të gjitha palët e përfshira. Çdo iniciativë nga ana e Ministrisë që synon zgjidhjen e mosmarrëveshjes në fjalë në përputhje me acquis të Komunitetit të Energjisë, duke përfshirë këtu negociatat shtesë, do të përkrahët në mënyrë aktive nga Sekretariati”.*<sup>28</sup>

**17.** Pas përgjigjes së Serbisë ndaj Mendimit të Arsyetuar lidhur me **Rastin ECS-3/08**, të datës 7 tetor 2011, EnCS në Përfundimet e Kërkesës së Arsyetuar lidhur me **Rastin ECS-3/08**, të datës 20 korrik 2016, kërkoi nga Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë *“të deklarojë në përputhje me Nenin 91(1)(a) të Traktatit mbi themelimin e Komunitetit të Energjisë se:*

- a. *Duke mos shfrytëzuar të hyrat që realizohen nga alokimi i interkoneksionit në linjat e interkoneksionit me Shqipërinë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (tani Maqedonia e Veriut) dhe Malin e Zi për njërin apo disa nga qëllimet e specifikuar në Nenin 6(6) të Rregullores 1228/2003, Republika e Serbisë, së cilës i ngarkohen veprimet dhe joveprimet e operatorit të saj shtetëror të sistemit të transmisionit, dështon të respektojë Nenin 6 të Rregullores 1228/2003”.*<sup>29</sup>

---

<sup>27</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2011), ‘Mendim i Arsyetuar lidhur me Rastin ECS 03/08, i datës 7 tetor 2011’. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>28</sup> Po aty.

<sup>29</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2016), ‘Kërkesa e Arsyetuar e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, e datës 20 korrik 2016’ Pika 95. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

18. Në Mendimin e vet, të datës 10 tetor 2016, Komisioni Këshillëdhënës lidhur me **Rastin ECS-3/08** i dha përkrahje Përfundimeve të Kërkesës së Arsytuar të EnCS lidhur me **Rastin ECS-3/08**, të datës 20 korrik 2016.<sup>30</sup> Në Mendimin e vet, Komisioni Këshillëdhënës erdhi në përfundimin se *“Serbia ka dështuar të respektojë Nenin 12 të Traktatit të ndërlidhur me Nenin 6(6) të Rregullores 1228/2003”*.

19. Më 14 tetor 2016, pas Përfundimeve të Kërkesës së Arsytuar të EnCS dhe Përfundimeve të Mendimit të Komisionit Këshillëdhënës të EnC, duke pas parasysh përgjigjen e Serbisë, bazuar në Traktatin e Komunitetit të Energjisë MC-EnC mori vendimin në vijim:

- a. *“Duke mos shfrytëzuar të hyrat që realizohen nga alokimi i interkoneksionit në linjat e interkoneksionit me Shqipërinë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Malin e Zi për njërin apo disa nga qëllimet e specifikuar në Nenin 6(6) të Rregullores 1228/2003, Republika e Serbisë, së cilës i ngarkohen veprimet dhe joveprimet e operatorit të saj shtetëror të sistemit të transmisionit, dështon të respektojë Nenin 6 të Rregullores 1228/2003”* (Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë, 2016).<sup>31</sup>

20. Në Nenin 2 të Vendimit 2016/02/MC-EnC, MC-EnC ka paraparë veprime përcjellëse. Rrjedhimisht, *“Republika e Serbisë duhet të ndërmarrë të gjitha masat përkatëse për të korrigjuar shkeljen e identifikuar në Nenin 1 dhe të veprojë në përputhje me Ligjin e Komunitetit të Energjisë të dhjetorit 2016. Republika e Serbisë duhet të raportojë në baza të rregullta te Sekretariati dhe te Grupi i Lartë Permanent në lidhje me të gjitha masat e ndërmarra”*. Gjithashtu, në bazë të vendimit, MC-EnC ftoi EnCS të *“inicojë procedurën sipas Nenit 92 të Traktatit”*, në rast se Serbia dështon të korrigjojë

---

<sup>30</sup> Komisioni Këshillëdhënës i Komunitetit të Energjisë (2016), ‘Mendim lidhur me Rastin ECS 03/08 kundër Serbisë’. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>31</sup> Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë (2016), ‘Vendim 2016/02/MC-EnC, i datës 14 tetor 2016’. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

shkeljet. Ky Vendim ka hyrë në fuqi në momentin e aprovimit dhe i është dorëzuar institucioneve të EnCT si dhe Palëve.<sup>32</sup>

**21.** Pas dështimit të Serbisë që të respektojë Vendimin 2016/02/MC-EnC të MC-EnC dhe t'i korrigjojë shkeljet, EnCS bazuar në Nenin 92 të EnCT ka inicuar Kërkesën për Sanksionim për **Rastin ECS-3/08**, të datës 12 tetor 2017. Përmes kësaj Kërkese, EnCS kërkoi nga MC-EnC marrjen e Vendimit që: 1) *“Dështimi i Republikës së Serbisë për të zbatuar Vendimin e Këshillit Ministror 2016/02/MC-EnC dhe kështu dështimi për ta korrigjuar shkeljen e identifikuar në këtë Vendim përbën shkelje të vazhdueshme dhe serioze në përputhje me Nenin 92(1) të Traktatit”*. Po ashtu, Sekretariati kërkoi nga EnC-MC që ta nxitë Serbinë që *“të ndërmarrë të gjitha masat e duhura për të korrigjuar shkeljen e identifikuar në Vendimin e Këshillit Ministror 2016/02/MC-EnC në bashkëpunim me Sekretariatit”* dhe t'ia sigurojë EnCMC raportet e zbatimit mbi masat e ndërmarra, deri në 2018. Sipas kësaj Kërkese, EnCMC do ta ftojë EnCS për të monitoruar respektimin nga ana e Serbisë të EnC *acquis communautaire* dhe për të inicuar procedurën për vendosjen e masave sipas Nenit 92 të Traktatit, nëse Serbia nuk korrigjon shkeljet deri më 1 korrik 2018.<sup>33</sup>

**22.** Më 29 nëntor 2018, duke pas parasysh (i) EnCT, (ii) Vendimin e MC-EnC 2016/02/MC-EnC lidhur me **Rastin ECS-3/08**, (iii) dështimin e Serbisë për të korrigjuar shkeljet e identifikuar dhe kështu dështimin për të respektuar EnCT deri më 7 dhjetor 2016, (iv) ftesën e MC-EnC për EnCS që të iniciojë procedurë sipas Nenit 92 të EnCT, nëse shkeljet e identifikuar në Vendimin e MC-EnC 2016/02/MC-EnC nuk korrigjohen deri në dhjetor 2016, si dhe (iv) faktin që asnjë masë e prekshme nuk është ndërmarrë nga ana e Serbisë për zbatimin e Vendimit të MC-

---

<sup>32</sup> Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë (2016), 'Vendim 2016/02/MC-EnC, i datës 14 tetor 2016 – Neni 3'. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>33</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2017), 'Kërkesa e Arsyetuar lidhur me Rastin ECS 03/08 kundër Serbisë, e datës 12 tetor 2017'. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308SRS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

EnC 2016/02/MC-EnC, duke marrë për bazë kërkesën e EnCS, MC-EnC mori Vendimin 2018/12/MC-EnC.<sup>34</sup>

**23.** Sipas Vendimit të MC-EnC 2018/12/MC-EnC, *“Përderisa Republika e Serbisë nuk i korrigjon shkeljet e identifikuar në Vendimin e MC-EnC 2016/02/MC-EnC brenda gjastë muajve nga Vendimi aktual, dështimi i Serbisë për të implementuar Vendimin e MC-EnC 2016/02/MC-EnC do të konsiderohet si shkelje serioze dhe e vazhdueshme në kuptimin e Nenit 92(1) të Traktatit”*. Pjesa e mbetur e përmbajtje së këtij Vendimi është e ngjashme me atë të Vendimit të MC-EnC 2016/02/MC-EnC. Sipas Vendimit, MC-EnC, sërish, nxiti Serbinë që *“të ndërmarrë të gjitha masat e duhura për të korrigjuar shkeljen e identifikuar në Vendimin e Këshillit Ministror 2016/02/MC-EnC në bashkëpunim me Sekretariatit”* dhe t’ia sigurojë EnCMC raportet e zbatimit mbi masat e ndërmarra në 2018. Për më shumë, EnCS u ftua që të monitorojë respektimin nga ana e Serbisë të EnC *acquis communautaire* dhe të kërkojë vendosjen e masave sipas Nenit 92 të Traktatit në 2019, nëse Serbia nuk e zbaton Vendimin e MC-EnC 2016/02/MC-EnC deri më 1 korrik 2019. Ky Vendim hyri në fuqi me rastin e miratimit të tij dhe iu dorëzua institucioneve të EnCT dhe Palëve (Neni 3, Vendimi i MC-EnC 2018/12/MC-EnC).

**24.** Duhet të theksohet se, siç është cekur në Pikën 88 të Mendimit të Arsyetuar të EnCS, të datës 7 tetor 2011, Rregullorja 1228/2003, për fat të keq, nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për kompenzimin e KOSTT për shpenzimet që i ka shënuar gjatë periudhës para hyrjes në fuqi të EnCT.<sup>35</sup> Një qëndrim i ngjashëm është paraparë edhe në Nenin 3.1 të Marrëveshjes Kornizë.<sup>36,37</sup> Para hyrjes në fuqi të EnCT, raportet

---

<sup>34</sup> Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë (2018), ‘Vendim 2018/12/MC-EnC’. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308SRS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>35</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2011), ‘Mendim i Arsyetuar lidhur me Rastin ECS 03/08, i datës 7 tetor 2011’. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>36</sup> Neni 3.1 thotë se Marrëveshja Kornizë “nuk do të ketë ndonjë ndikim në pretendimet potenciale që rrjedhin nga raportet në mes të Palëve për periudhën para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje”

<sup>37</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2016), ‘Kërkesa e Arsyetuar e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, e datës 20 korrik 2016’. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

në mes të KOSTT dhe EMS lidhur me energjinë elektrike në tranzit janë qeverisur nga Marrëveshja e Përkohshme mbi Shkëmbimin e Energjisë e vitit 2000. Sipas Pikës 1.4.2 të Marrëveshjes së Përkohshme mbi Shkëmbimin e Energjisë së vitit 2000 *"pala për të cilën realizohet tranziti i energjisë elektrike do t'ia rimbursojë shpenzimet e tranzitit palës tjetër, në të mira ose në bazë financiare"*. Prandaj, për të kompensuar KOSTT për shpenzimet e energjisë elektrike në tranzit, siç është elaboruar në **Rastin ECS-3/08**, për periudhën para hyrjes në fuqi të EnCT, EMS duhet të respektojë Marrëveshjen e Përkohshme mbi Shkëmbimin e Energjisë të vitit 2000.

## **Dialogu i Brukselit dhe Mosmarrëveshja lidhur me Energjinë në mes të KOSTT dhe EMS**

25. Pas arritjes së "Marrëveshjes së Parë mbi Parimet që Qeverisin Normalizimin e Marrëdhënieve" në mes të Kosovës dhe Serbisë, më 8 shtator 2013, vendet arritën "Marrëveshjen mbi energjinë", ku palët *"konfirmuan përkushtimin e tyre për të plotësuar të gjitha obligimet e tyre që rrjedhin nga Traktati mbi Komunitetin e Energjisë dhe të zbatojnë ligjet mbi energjinë të BE"*. Sipas këtij dokumenti, Kosova dhe Serbia u pajtuan: (i) që të themelojnë një kompani të re tregtare, (ii) që të themelojnë një kompani të re për shërbime të furnizimit dhe distribuimit dhe (iii) për dhënien e licencës së furnizimit nga ana e Zyrës Rregullative të Energjisë të Kosovës. Të dyja palët u pajtuan që *"KOSTT do të pranohet si Operator Sistemi dhe Transmisioni në territorin e Kosovës me qëllimin që të marrë pjesë në të gjithë mekanizmat relevantë (ITC, Menaxhim të Kongjestionit, etj.)"*. Po ashtu, marrëveshja parashihte që EMS do të përkrahë anëtarësimin e KOSTT në ENTSO-E. Sipas marrëveshjes, KOSTT dhe EMS do të nënshkruajnë një marrëveshje operacionale bilaterale, brenda tri muajve nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes mbi Energjinë, me ç'rast do të shfuqizohet Marrëveshja e Përkohshme për Shkëmbimin e Energjisë

e vitit 2000<sup>38</sup> dhe Marrëveshja e Përkohshme Teknike e vitit 2001.<sup>39</sup> Marrëveshja parashihte që KOSTT do të rilidhë linjën 110 kV në Valac dhe do të marrë nën kontroll të plotë nënstacionin në Valac në kufirin midis Kosovës dhe Serbisë. Kështu, KOSTT si i vetmi OST do të fitojë kontrollin e plotë mbi rrjetin e Kosovës.

26. Pasi kaloi një vit me negociata të lehtësuara edhe nga KE edhe nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, më 12 shkurt 2014, KOSTT dhe EMS nënshkruan një marrëveshje ligjërish të obligueshme, gjegjësisht *“Marrëveshjen Kornizë lidhur me Bashkëpunimin dhe Koordinimin e Sistemeve të Transmisionit të ndërlidhura në mes të EMS dhe KOSTT”*.<sup>40</sup> Kjo marrëveshje ishte hapi i parë drejt plotësimit të obligimeve që rrjedhin nga Marrëveshja mbi energjinë e vitit 2013. Përmes Marrëveshjes Kornizë, KOSTT dhe EMS synuan që të rregullojnë çështjet lidhur me menaxhimin e kongestionit, kompenzimin ndër-OST pan-Evropian dhe zbatimin e standardeve të BE për operimin e rrjetit të transmisionit.

27. Marrëveshja mbi energjinë e vitit 2013 theksoi se palët nënshkruese u pajtuan që *“të gjejnë një zgjidhje të përbashkët lidhur me pretendimet e KOSTT dhe pretendimet e EMS. KOSTT konsideron që këto pretendime kanë të bëjnë me tranzitin e papaguar dhe me të hyrat e papaguara të alokimit të interkoneksionit, ndërsa EMS konsideron se këto pretendime kanë të bëjnë me rregullativën sekondare. EMS konsideron se këto pretendime janë për shërbimet e rregullimit sekondar dhe terciar”*. Marrëveshja potencoi edhe se palët dështuan që bashkërisht të zgjidhin këtë çështje (pretendimet e KOSTT dhe pretendimet e EMS) brenda gjashtë muajve, *“të dyja palët u pajtuan që këto pretendime t’i dorëzojnë në arbitrazhin ndërkombëtar”*.<sup>41</sup>

---

<sup>38</sup>UNMIK (2000), ‘Marrëveshja e Përkohshme për Shkëmbimin e Energjisë. Në Kërkesën e Arsyetuar të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë’. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>39</sup>UNMIK (2001), ‘Marrëveshja e Përkohshme Teknike. Në Kërkesën e Arsyetuar të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë’. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>40</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2016), ‘Kërkesa e Arsyetuar e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, e datës 20 korrik 2016’. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>41</sup> Po aty.

**28.**Në bazë të Nenit 1.3 të Marrëveshjes Kornizë, “KOSTT merr përgjegjësitë për zonën e vet në kuadër të Zonës së Sinkronizuar të Evropës Kontinentale dhe si pjesë e Bllokut të Kontrollit që përbëhet nga sistemet e transmisionit të Palëve dhe të CGES dhe MEPSO fqinje, me kusht që pajtohen OST e zonave tjera të Bllokut të Kontrollit”. Sipas Pikës 2.2 të Marrëveshjes Kornizë, KOSTT dhe EMS do të “përmirësojnë vazhdimisht bashkëpunimin e tyre në të gjitha fushat e operimeve të sistemit, me qëllim që të themelohet një Zonë Kontrolli e operuar nga KOSTT në përputhje me Manualin mbi Operimin të ENTSO-E... dhe EMS do të përkrah anëtarësimin e KOSTT në ENTSO-E”.

**29.**Më 15 shtator 2014, pas një raundi të tjetër negociatash të lehtësuara nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, KOSTT dhe EMS zhvilluan dhe nënshkruan një marrëveshje ligjërish të obligueshme, gjegjësisht “Marrëveshjen ndër-OST mbi Menaxhimin e Operimit të Rrjetit dhe Sistemit mes EMS dhe KOSTT”. Kjo marrëveshje ka për qëllim “të përcaktojë rregullat dhe regjimet e caktuara që vlejné për bashkëpunimin në mes të EMS dhe KOSTT, në mënyrë që të sigurohet operimi i sigurt i rrjetit të transmisionit të interkonektuar. Më së hershmi, më 1 janar 2015, KOSTT dhe EMS do të operojnë sistemet e transmisionit nën përgjegjësitë e tyre si dy Zona Kontrolli të veçanta/ndara, nën kushtin që KOSTT të përkushtohet për respektimin e standardeve të aplikueshme të specifikuara në Manualin mbi Operimin të ENTSO-E dhe çfarëdo kërkesash tjera që mund të caktojë ENTSO-E”.

**30.**Palët u pajtuan që Marrëveshja Kornizë dhe Marrëveshja ndër-OST të hyjnë në fuqi më 12 shkurt 2014, respektivisht 15 shtator 2014. Përveç kësaj, ato u pajtuan që me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes ndër-OST, kjo e fundit do ta zëvendësojë Marrëveshjen e Përkohshme për Shkëmbimin e Energjisë të vitit 2000 dhe Marrëveshjen e Përkohshme Teknike të vitit 2001.

**31.**Deri më sot, as Marrëveshja Kornizë as Marrëveshja ndër-OST nuk është zbatuar.<sup>42</sup>

---

<sup>42</sup> Komuniteti i Energjisë (2019), ‘Raporti mbi Monitorimin e Energjisë Elektrike në WB6’. Në dispozicion në: [https://www.energy-community.org/regionalinitiatives/WB6/Monitoring\\_EL.html](https://www.energy-community.org/regionalinitiatives/WB6/Monitoring_EL.html) [Qasur më: 6 shtator 2019].



32. Më 9 korrik 2015, pas disa vitesh diskutime dhe negociata në mes të EMS dhe KOSTT, edhe nën kujdesin e Komisionit Evropian edhe të Sekretariatit, në bazë të vendimit të marrë gjatë Mbledhjes Plenare të RG CE, Marrëveshja e Kyçjes në mes të ENTOS-E dhe KOSTT u miratua, sipas së cilës KOSTT do të bëhet një sistem i pavarur transmisioni i një pjese të Zonë së Sinkronizuar të Evropës Kontinentale.
33. Me miratimin e Marrëveshjes së Kyçjes, pavarësisht nga arritja e marrëveshjeve lidhur me përkushtimet për të përkrahur anëtarësimin e KOSTT në ENTSO-E, në kuadër të Dialogut të lehtësuar nga BE, si dhe nën kujdesin e EnCS dhe në kuadër të Traktatit të EnC, më 22 korrik 2015, Serbia dorëzoi një kërkesë për rishikim lidhur me Marrëveshjen e Kyçjes për KOSTT mbi bazën e asaj se *“ky vendim është seriozisht paragjykses ndaj interesave të saj”*. Vendimi mbi Marrëveshjen e Kyçjes u pezullua në bazë të Nenit 6.1 të Termave të Referencës së RG CE.<sup>43</sup> Duke pas këtë parasysh, kryesuesi i mbledhjes plenare të RG CE, z. Baumann kërkoi nga EMS që të dorëzojë një kërkesë për rishikim deri më 14 gusht 2015.<sup>44</sup> Më 1 shtator 2015, si rezultat i miratimit të kërkesës për shtyrjen e afatit, EMS dorëzoi formulimin e plotë të kërkesës për rishikim.
34. Më 25 gusht 2015, para se të dorëzojë kërkesën për rishikim, Serbia vazhdoi negociatat me Kosovën në kuadër të Dialogut të lehtësuar nga BE. Palët u pajtuan për një plan veprimi mbi zbatimin e obligimeve që rrjedhin nga Marrëveshja mbi energjinë e vitit 2013. Dokumenti përbëhej nga 17 nene dhe një klauzolë që janë përfshirë në “Raportin e datës 25 gusht 2015 mbi përfundimet e lehtësuesit të BE mbi zbatimin e Marrëveshjes mbi Energjinë.”<sup>45</sup> Ky veprim është vetëm një provë shtesë në grumbullin e provave të hipokrizisë së Serbisë të shprehur gjatë gjithë procesit të normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën.

---

<sup>43</sup> Neni 6.1 i RG CE parasheh pezullimin e vendimit, i cili është i kushtëzuar me kërkesë për rishikim, derisa të merret një vendim final në Mbledhjen Plenare.

<sup>44</sup> Shënim për Evropa Kontinentale Grupi Rajonal, 16 shtator 2015.

<sup>45</sup> Bashkësia Evropiane (2015), ‘Raporti mbi përfundimet e lehtësuesit të BE mbi zbatimin e Marrëveshjes mbi energjinë të vitit 2013’. Në dispozicion në: [http://eeas.europa.eu/archives/docs/statements-eeas/docs/facilitated-dialogue/150825\\_02\\_conclusions-on-the-implementation-of-energy-agreement\\_en.pdf](http://eeas.europa.eu/archives/docs/statements-eeas/docs/facilitated-dialogue/150825_02_conclusions-on-the-implementation-of-energy-agreement_en.pdf) [Qasur më: 6 shtator 2019].



- 35.** Raporti mbi përfundimet e lehtësuesit të BE i datës 25 gusht 2015 (tani e tutje Raporti mbi përfundimet) specifikon që për të përmbushur obligimet që rrjedhin nga Marrëveshja për energjinë e vitit 2013, Kosova dhe Serbia u pajtuan si vijon: (i) të themelohet një kompani e re tregtare, (ii) të themelohet një kompani e re për shërbime të furnizimit dhe distribuimit, (iii) për dhënien e licencës për furnizim nga ana e Zyrës Rregullative të Energjisë së Kosovës, (iv) që shërbimet e distribuimit të ofrohen nga kompania e re për furnizim dhe distribuim, (v) që Serbia dhe EMS t'i ofrojnë ndihmë KOSTT në aplikimin e tij për të nënshkruar Marrëveshjen e Kyçjes me ENTSO-E, duke përfshirë këtu procesin e apelit, si dhe (vi) të zbatojnë të gjitha pikat e specifikuara në Raportin mbi përfundimet pavarësisht nga progresi në pikën 15 (në këtë dokument pika e shënjuar si vijon “(iv) që shërbimet e distribuimit të ofrohen nga kompania e re për furnizim dhe distribuim”).
- 36.** Serbia ishte e suksesshme me kërkesën e saj për rishikim, meqë, sipas Nenit 16 të Marrëveshjes së Kyçjes, hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Kyçjes për Kosovën u kushtëzua me dy kritere, gjegjësisht: *“a. Të gjitha Palët e kanë nënshkruar Marrëveshjen në fjalë; dhe b. Licenca për furnizim e kompanisë serbe në Kosovë (“ElektroSever”) është lëshuar dhe është operacionalizuar”*.<sup>46</sup>
- 37.** Mirëpo, siç është shpjeguar nga EnCS, sipas Marrëveshjes mbi energjinë të vitit 2013, përkrahja e Serbisë për anëtarësimin e KOSTT në ENTSO-E nuk u kushtëzua me dhënien e licencës për furnizim për kompaninë serbe.<sup>47</sup>
- 38.** Kompania ElektroSever, si pjesë e Ndërmarrjes për Energji Elektrike e Serbisë, u regjistrua në Agjencionin Kosovar për Regjistrimin e Bizneseve vetëm në nëntor të vitit 2018. Vonesat në licencimin e saj ishin rezultat i shkeljeve të Raportit mbi përfundimet të vitit 2015 nga ana e Serbisë, e cila nuk respektoi ligjet dhe kornizën rregullative të Kosovës gjatë procesit të regjistrimit të po kësaj kompanie. Licencimi

---

<sup>46</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2016), ‘Kërkesa e Arsytuar e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, e datës 20 korrik 2016’. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>47</sup> Shënim për Evropa Kontinentale Grupi Rajonal, 16 shtator 2015.

i kompanisë është parakusht për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Kyçjes dhe anasjelltas.

**39.** Më 2 korrik 2019, gjatë kohës së përpilimit të këtij dokumenti, në Mbledhjen Plenare të RG CE u vendos për një Marrëveshje të Kyçjes të re në mes të ENTSO –E dhe KOSTT. Marrëveshja parasheh që jo më vonë se deri në prill të vitit 2020 KOSTT do të bëhet një Bllok/Zonë Rregullatore në kuadër të Evropës Kontinentale, gjë që do t'i mundësojë KOSTT të realizojë menaxhimin e kongestionit dhe alokimin e kapacitetit në tri linjat e interkoneksionit të Palëve Kontraktuese fqinje në fjalë.

**40.** Duhet të ceket se Kosova dhe Serbia u pajtuan që të mos pajtohen mbi çështjen e pronës në territorin e Kosovës, në këtë rast në lidhje me pronat në sektorin e energjisë. Sipas klauzolës së Raportit mbi përfundimet, Kosova dhe Serbia kanë qëndrime diametralisht të kundërta lidhur zotërimin/pronësinë e pronave në territorin e Kosovës. Përfaqësuesit e Kosovës deklaruan se *“në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjet e Kosovës dhe ligjin ndërkombëtar, gjegjësisht UNSCR 1244 dhe Rreguloret përkatëse të UNMIK, pasuria në territorin e Kosovës është në pronësinë e Republikës së Kosovës”*. Përfaqësuesit e Serbisë, në anën tjetër, pretendojnë se *“në përputhje me ligjet vendore dhe ndërkombëtare, gjegjësisht UNSCR 1244, pasuria brenda territorit të Kosovës është në pronësi të Serbisë, sipas rregulloreve specifike provinciale dhe në pajtueshmëri të plotë me Kushtetutën e Serbisë”*. Ky dallim thelbësor në mes të qëndrimeve të palëve lidhur me pronësinë, në këtë rast me pasurinë/pronat në sektorin e energjisë në territorin e Kosovës paraqet një pengesë serioze për zbatimin e Marrëveshjes për energjinë të vitit 2013.

**41.** Çështja e pronësisë është trajtuar edhe nga EnCS. Duke reaguar ndaj përgjigjes së Serbisë, EnCS në Mendimin e Arsytuar (Pika 53), të datës 7 tetor 2011, dhe në Kërkesën e Arsytuar lidhur me **Rastin ECS-3/08** (Pika 73), të datës 20 korrik 2016, thekson se vlerësimi ligjor *“nuk ka ndikim dhe nuk varet nga pyetja lidhur me pronësinë mbi rrjetin e transmisionit. Ligji i Komunitetit të Energjisë është neutral ndaj çështjes së pronësisë, e cila mbetet të përcaktohet në përputhje me ligjin e*

*përgjithshëm mbi pronën*".<sup>48</sup> Megjithatë, në Pikën 70 të Mendimit të Arsyetuar, EnCS i referohet Pikës 61 dhe argumenton se "KOSTT ka në pronësi asetet e transmisionit në Kosovë".<sup>49</sup>

## **Humbjet Financiare të KOSTT që Rrjedhin nga Mospagesa e Faturave të Energjisë Elektrike në Pjesën Veriore të Kosovës**

**42.** Që nga viti 1999, KEK, i cili sipas kornizës ligjore të Kosovës ishte përgjegjës, ndër të tjera, për operimin e rrjetit të energjisë elektrike në territorin e Kosovës, ka hasur në pengesa në operimin e rrjetit energjetik në pjesën veriore të vendit – me përfundimin e procesit të ndarjes kjo përgjegjësi i ka kaluar KOSTT përmes lincencimit nga ana e ZRRE.<sup>50</sup> Rrjeti energjetik në pjesën veriore të territorit të Kosovës jashtëligjshëm është operuar nga një kompani serbe, e themeluar nga EPS, me të cilën kanë nënshkruar kontrata konsumatorët e kyçur në rrjet në atë pjesë të territorit të Kosovës. Prandaj, konsumatorëve që kanë jetuar në Leposaviq, Mitrovicën Veriore dhe Zubin Potok u janë lëshuar faturat e rrymës elektrike nga kompania serbe.<sup>51</sup><sup>52</sup> Sipas këtyre autorëve, EPS ka pretenduar se nuk ka qenë e përfshirë në operimin e rrjetit energjetik në pjesën veriore të Kosovës. Mirëpo, sipas Kërkesës së Arsyetuar të EnCS, të datës 22 korrik 2015, EMS në Pikën 3 të propozimit të saj e pranon se ajo bën furnizimin me energji elektrike në pjesën veriore të Kosovës "... për t'ia mundësuar ofruesit ekzistues EPS vazhdimin e furnizimit për konsumatorët në veri...". Duke pas parasysh këtë situatë, që nga viti

---

<sup>48</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2016), 'Kërkesa e Arsyetuar e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, e datës 20 korrik 2016'. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>49</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2011), 'Mendim i Arsyetuar lidhur me Rastin ECS 03/08, i datës 7 tetor 2011'. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>50</sup> Ministria e Energjisë dhe Minierave (2009), 'Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës'. Në dispozicion në: [http://www.mei-ks.net/repository/docs/ANNEX\\_12\\_-\\_Kosovo\\_Energy\\_Strategy\\_2009-2018.pdf](http://www.mei-ks.net/repository/docs/ANNEX_12_-_Kosovo_Energy_Strategy_2009-2018.pdf) [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>51</sup> Konsumatorëve që kanë jetuar në komunën e Zvecanit u janë lëshuar faturat e rrymës elektrike nga Trepca.

<sup>52</sup> Sovrlić, S. dhe Đapić S. (N/A), 'Errësira dhe Heshtja pas Marrëveshjes së Brukselit'. Në dispozicion në: <http://crnobelisvet.com/wp-content/uploads/2018/02/DARKNESS-AND-SILENCE-AFTER-THE-BRUXELLES-AGREEMENT.pdf> [Qasur më: 6 shtator 2019].

1999 konsumatorët në pjesën veriore të territorit të Kosovës asnjëherë nuk ia kanë paguar KEK faturat e rrymës. Sipas Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, në vitin 2008 shuma totale e faturave të rrymës të papaguara ka arritur vlerën prej **145 milion Euro**. Në vitin 2009, një numër i konsumatorëve të kyçur në rrjetin në pjesën veriore të Kosovës kanë nënshkruar kontrata me KEK.

**43.**Në bazë të komunikatës për shtyp të Këshillit Kosovar për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (tani e tutje KMLDNJ), të datës 10 korrik 2019, për 17 vite me radhë, konsumatorëve të rregulltë të Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (tani e tutje KEDS) përmes tarifave për energji elektrike jashtëligjshëm u janë ngarkuar për pagesë humbjet e KEDS që rrjedhin nga mospagesa e faturave të energjisë elektrike nga ana e konsumatorëve të kyçur në rrjetin energjetik në pjesën veriore të Kosovës.<sup>53</sup> Siç shpjegohet nga KMLDNJ, humbja financiare – që rezulton nga mospagesa e energjisë elektrike nga ana e konsumatorëve të kyçur në rrjetin energjetik në pjesën veriore të Kosovës – iu është bartur si ngarkesë financiare konsumatorëve të rregulltë përmes tarifave të energjisë elektrike më të larta. Konsiderohet se shuma totale e kësaj ngarkese financiare arrin vlerën prej rreth **12 milion Euro në vit**. Për një periudhë prej 17 vitesh, kjo jep një vlerë totale prej rreth **204 milion Euro**.

**44.**Ndërkohë, qeveria e Kosovës ka premtuar se do t'i kompenzojë konsumatorët e rregulltë për ngarkesën financiare, e cila iu është vendosur atyre jashtëligjshëm nga ana e KOSTT përmes faturave të energjisë elektrike më të shtrenjta.<sup>54</sup> Deri më sot, konsumatorët e rregulltë të KOSTT nuk janë kompenzuar për dëmin financiar që atyre iu është shkaktuar padrejtësisht.

**45.**Deri më sot, çështja dhe shuma totale e humbjes financiare që rrjedhë nga mospagesa e faturave të energjisë elektrike nga ana e konsumatorëve të kyçur në

---

<sup>53</sup> KMDLNJ (2019), 'Serbët në veri ende nuk po paguajnë faturat e rrymës'. Në dispozicion në: <https://gazetainfokus.com/kmdlj-serbet-ne-veri-ende-nuk-po-paguajne-faturat-e-rrymes/> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>54</sup> Po aty.

rrjetin energjetik në pjesën veriore të Kosovës, edhe nëse është diskutuar, fatkeqësisht, nuk është evidentuar në asnjërin nga dokumentet që kanë dalë nga aranzhimet dhe marrëveshjet mbi energjinë të arritura në mes të Kosovës dhe Serbisë (dhe/ose në mes të KOSTT dhe EMS). Në shkurt të vitit 2015, kompania serbe, e cila operon në pjesën veriore të Kosovës, ka filluar një fushatë, përmes së cilës konsumatorëve në pjesën veriore të Kosovës iu ka lëshuar fatura të energjisë elektrike që përmbajnë borxhet përkatëse për periudhën 1 dhjetor 2012 - 31 dhjetor 2014, duke përfshirë këtu edhe një vërejtje për çkyçje në rast të mospagesës deri më datën 4 mars 2015.<sup>55</sup> Kjo fushatë është ndërprerë pa ndonjë shpjegim. Më 31 tetor 2015, Serbia përmes një vendimi qeveritar krijoi grupin punues përgjegjës për themelimin e sistemit të mbledhjes së pagesave/borxheve të energji elektrike. Lidhur me këtë nuk ka ndonjë informacion shtesë.

**46.** Si përfundim, përderisa nuk është e qartë nëse konsumatorët në pjesën veriore të Kosovës ia kanë paguar faturat e energjisë elektrike kompanisë serbe, është shumë e qartë që borxhi financiar nga mospagesa e faturave të energjisë elektrike nga ana e konsumatorëve në pjesën veriore të Kosovës ka arritur vlerën prej **204 milion Euro**.<sup>56</sup>

## Dëmi Kolateral që Rrjedhë nga Shkelja e Traktatit mbi Komunitetin e Energjisë nga ana e Serbisë

**47.** Në qershor të vitit 2016, linja e interkoneksionit 400kV e posandërtuar në mes të Kosovës dhe Shqipërisë u inaugurua. Dy vendet dështuan të shënojnë progres në funksionalizimin e linjës së re të transmisionit për shkak të ngecjeve në procesin e

---

<sup>55</sup> Sovrlić, S. dhe Đapić S. (N/A), 'Errësira dhe Heshtja pas Marrëveshjes së Brukselit'. Në dispozicion në: <http://crnobelisvet.com/wp-content/uploads/2018/02/DARKNESS-AND-SILENCE-AFTER-THE-BRUXELLES-AGREEMENT.pdf> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>56</sup> KMDLNJ (2019), 'Serbët në veri ende nuk po paguajnë faturat e rrymës'. Në dispozicion në: <https://gazetainfokus.com/kmdlj-serbet-ne-veri-ende-nuk-po-paguajne-faturat-e-rrymes/> [Qasur më: 6 shtator 2019].

nënshkrimit të Marrëveshjes së Kycjes në mes të ENTSO-E dhe KOSTT. Marrëveshja e Kycjes në mes të ENTSO-E dhe KOSTT nuk mund të hynte në fuqi për shkak të mosmarrëveshjes së gjatë politike në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në veçanti, kjo ishte për shkak të ngecjes në plotësimin e obligimeve të tyre që rrjedhin nga Aranzimet për energjinë të vitit 2015 lidhur me licencën për furnizim që duhej t'i lëshohej kompanisë ElektroSever nga ana e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë së Kosovës (për më shumë detaje lexo Pikën 37 në këtë dokument). Në korrik të vitit 2019, Marrëveshja e Kycjes u miratua dhe e njëjta do të hyjë në fuqi më 14 prill 2020. Si rezultat, në ditën e njëjtë (14 prill 2020) linja e interkoneksionit 400kV me Shqipërinë do të operacionalizohet.

**48.** Në një intervistë, z. Zeqo<sup>57</sup>, kryetar i Operatorit të Sistemit dhe Transmisionit të Shqipërisë, theksoi se linja e transmisionit 400kV në mes të Shqipërisë dhe Kosovës është zhvlerësuar gjatë këtyre katër viteve që nuk ka qenë në shfrytëzim. Ai, gjithashtu, shpjegoi se, për shkak të pamundësisë për ta shfrytëzuar linjën e re të transmisionit, Kosova dhe Shqipëria kanë pësuar **humbjen e të hyrave tarifore** në vlerë prej 500 mijë deri në 1 milion Euro çdo vit. Nëse merret mesatarja vjetore prej 750 mijë Euro si vlerë të **të hyrave vjetore tarifore të humbura** dhe shumëzohet me katër vite – periudha e gjithmbarshme gjatë së cilës linja e transmisionit ka mundur të shfrytëzohet – jep një vlerë totale të **të hyrave vjetore tarifore të humbura prej 3 milion Euro**. Rrjedhimisht, Kosova dhe Shqipëria kanë humbur rreth **3 milion Euro**, për shkak se Serbia ka kushtëzuar operacionalizimin e linjës së interkoneksionit me licencimin e ElektroSever.

---

<sup>57</sup>RadioTelevizioniShqiptar (2017), 'Linja 400 kV me Kosovën, Shqipëria sugjeron arbitrazhin'. Në dispozicion në: <https://www.rtsh.al/lajme/linja-400-kv-me-kosoven-shqiperia-sugjeron-arbitrazhin/> [Qasur më: 6 shtator 2019].

## Përfundimet

**49.** Raportet bilaterale mbi energjinë, duke përfshirë këtu edhe energjinë në tranzit, në mes të KOSTT dhe EMS janë themeluar në vitin 2000 dhe janë qeverisur përmes Marrëveshjes së Përkohshme mbi Shkëmbimin e Energjisë së vitit 2000<sup>58</sup> dhe Marrëveshjes së Përkohshme Teknike të vitit 2001.<sup>59</sup> Këto dy marrëveshje janë ligjërisht të obligueshme për KOSTT dhe EMS, meqë u nënshkruan nga Palët Kontraktuese respektive dhe asnjëherë nuk janë shkëputur/anuluar. Mirëpo, në vitin 2004, për shkak të hyrjes në fuqi të disa ITC marrëveshjeve, në të cilat EMS ishte palë nënshkruese, Serbia përmes EMS unilateralisht filloi të shkelë këto dy marrëveshje me Kosovën. Si rezultat, EMS ndaloi së transferuari në KOSTT mjetet që EMS i pranonte për alokimin e kapacitetit të transmisionit në tri linjat e interkoneksionit të Palëve Kontraktuese fqinje me rrjetin e operuar nga KOSTT, gjegjësisht Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi.

**50.** Në vitin 2006, Kosova u bë anëtare e Komunitetit të Energjisë, me ç' rast KOSTT u caktua si i vetmi OST në territorin e Kosovës në përputhje me Nenin 8 të Direktivës 2003/54/EC. Përkundër faktit që është Palë Kontraktuese e Traktatit të EnC, Serbia përmes EMS ende e shkelë EnCT duke vazhduar të mos ia transferojë KOSTT të hyrat e realizuara nga alokimi i kapacitetit në tri linjat e interkoneksionit të Palëve Kontraktuese fqinje me rrjetin e operuar nga KOSTT, gjegjësisht Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi.

**51.** Në këtë drejtim, duhet të theksohet se Serbia përmes EMS e pengoi KOSTT në pjesëmarrjen e tij në mekanizmat ITC, edhe pse KOSTT kishte dhe ka të drejtë të anëtarësohet në këta organizma. ITC marrëveshja në mes të ENTSO-E dhe 39 OST e listoi EMS edhe si palë ITC edhe si Shtet/Blok Kontrolli për Serbinë, por pa iu referuar në mënyrë specifike territorit të Kosovës. Sipas Rregullores Nr 838/2010,

---

<sup>58</sup> UNMIK (2000), 'Marrëveshja e Përkohshme për Shkëmbimin e Energjisë. Në Kërkesën e Arsyetuar të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë'. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

<sup>59</sup> UNMIK (2001), 'Marrëveshja e Përkohshme Teknike. Në Kërkesën e Arsyetuar të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë'. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

KOSTT si OST që operon në territorin e Kosovës, gjegjësisht në territorin në të cilin vlen Ligji i Komunitetit të Energjisë, ka të drejtë të marrë pjesë në mekanizmin ITC. Përveç kësaj, asnjëra nga marrëveshjet e mëparshme (Marrëveshja e Përkohshme mbi Shkëmbimin e Energjisë, Marrëveshja e Përkohshme Teknike dhe Marrëveshja mbi Bllokun e Kontrollit SMM) nuk e ka mandatuar EMS të realizojë menaxhimin e kongestionit apo alokimin e kapacitetit në tri linjat e interkoneksionit. Për më shumë, sipas këtyre marrëveshjeve, EMS është e obliguar ligjërisht t'ia transferojë KOSTT të hyrat e realizuara nga alokimi i kapacitetit të transmisionit në tri linjat e interkoneksionit në fjalë.

52. Kosova vazhdimisht ka bërë përpjekje për të zgjidhur mosmarrëveshjet mbi energjinë përmes negociatave bilaterale dhe negociatave të ndihmuara nga ETSO dhe nga Komisioni Evropian, por pa sukses. Prandaj, në vitin 2008, KOSTT ngriti padi kundër Serbisë në Sekretariatit të Energjisë (EnCS), i cili hapi **Rastin ECS-3/08 kundër Serbisë**. Në përgjigjen e saj, Serbia tentoi të ofrojë arsyetim ligjor për veprimet e EMS duke pretenduar se veprimet e njëjta nuk paraqisnin shkelje, por pa sukses. EnCS rifokusoi lëndën e **Rastit ECS-3/08 kundër Serbisë** vetëm në çështjen e shfrytëzimit nga EMS të të hyrave të realizuara nga alokimi i kapacitetit të transmisionit në linjat e interkoneksionit fqinje me KOSTT. Pjesa e parë e lëndës së këtij rasti ligjor u trajtua në një rast tjetër ligjor të EnCS kundër Serbisë.

53. Në **Rastin ECS-3/08 kundër Serbisë**, Sekretariati i EnC erdhi në përfundim dhe kërkoi një vendim nga Këshilli Ministror i EnC. Më 14 tetor 2016, duke marrë për bazë Përfundimet e Kërkesës së Arsyetuar të EnCS, të datës 20 korrik 2016, dhe Përfundimet e Mendimit të Komisionit Këshillëdhënës, të datës 10 tetor 2016, si dhe përgjigjen e Serbisë, në bazë të Traktatit të Komunitetit të Energjisë MC-EnC mori Vendimin 2016/02/MC-EnC, në të cilin thuhet se *“Duke mos shfrytëzuar të hyrat që realizohen nga alokimi i interkoneksionit në linjat e interkoneksionit me Shqipërinë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Malin e Zi për njërin apo disa nga qëllimet e specifikuar në Nenin 6(6) të Rregullores 1228/2003, Republika e Serbisë,*



*së cilës i ngarkohen veprimet dhe mos-veprimet e operatorit të saj shtetëror të sistemit të transmisionit, dështon të respektojë Nenin 6 të Rregullores 1228/2003”.*<sup>60</sup>

**54.** Ka kaluar më shumë se një dekadë qysh kur ka filluar beteja ligjore lidhur me **Rastin ECS-3/08 kundër Serbisë** dhe, prap se prap, Serbia ende nuk ka filluar ta respektojë Vendimin e MC-EnC 2016/02/MC-EnC dhe të korrigjojë shkeljen e EnCT. Si pasojë, më 29 nëntor 2018, duke marrë parasysh faktin që asnjë masë e prekshme nuk është marrë nga ana e Serbisë për të zbatuar Vendimin e MC-EnC 2016/02/MC-EnC, MC-EnC mori Vendimin 2018/12/MC-EnC (lexo Pikën 22 të këtij dokumenti për më shumë detaje). Sipas këtij Vendimi, *“Përderisa Republika e Serbisë nuk i korrigjon shkeljet e identifikuar në Vendimin e MC-EnC 2016/02/MC-EnC brenda gjashtë muajve nga Vendimi aktual, dështimi i Serbisë për të zbatuar Vendimin e MC-EnC 2016/02/MC-EnC do të konsiderohet si shkelje serioze dhe e vazhdueshme në kuptimin e Nenit 92(1) të Traktati”*. Sërish, Serbia dështoi ta respektojë edhe këtë Vendim.

**55.** Serbia ndërkohë që **nuk respektonte** asnjë nga Vendimet e Këshillit Ministror të EnC lidhur me **Rastin ECS-3/08**, në anën tjetër “kinse” angazhohej në negociata, të lehtësuara nga BE si dhe nga EnCS, rreth normalizimit të raporteve me Kosovën lidhur me energjinë dhe përkushtohej për respektimin e të gjitha obligimeve që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë. Në kuadër të këtyre negociatave, Kosova dhe Serbia nënshkruan marrëveshjet në vijim: Marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013, Marrëveshjen lidhur me energjinë të vitit 2013, Aranzhimet lidhur me energjinë të vitit 2013, Raportin e përfundimeve të vitit 2015, Marrëveshjen Kornizë të vitit 2014, si dhe Marrëveshjen ndër-OST të vitit 2014. Deri më sot, asnjë masë e prekshme nuk është marrë nga ana e Serbisë për të zbatuar ndonjë nga këto marrëveshje.

---

<sup>60</sup> Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë (2016), ‘Vendim 2016/02/MC-EnC, i datës 14 tetor 2016’. Në dispozicion në: <https://www.energy-community.org/legal/cases/2008/case0308RS.html> [Qasur më: 6 shtator 2019].

56. Përkundër nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve, Serbia shkoi edhe më larg me obstrukcionet e veta dhe bllokoi hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Kyçjes të vitit 2015 në mes të ENTSO-E dhe KOSTT, duke e kushtëzuar me dy kritere, gjegjësisht: *“a. Të gjitha Palët e kanë nënshkruar Marrëveshjen në fjalë; dhe b. Licenca për furnizim e kompanisë serbe në Kosovë (“ElektroSever”) është lëshuar dhe është operacionalizuar”*. Paralelisht me këtë veprim, Serbia u angazhua për të vonuar regjistrimin dhe licencimin në Kosovë të ElektroSever, kompani e cila u licencua vetëm në nëntor të vitit 2018. Më 2 korrik 2019, në Mbledhjen Plenare të RG CE u vendos për një Marrëveshje të Kyçjes të re në mes të ENTSO –E dhe KOSTT, sipas së cilës jo më vonë se deri në prill të vitit 2020 KOSTT do të bëhet një Bllok/Zonë Rregullatore në kuadër të Evropës Kontinentale.

57. Dëmet financiare të Kosovës që rrjedhin nga veprimet dhe mos-veprimet e EMS që i ngarkohen Serbisë përbëhen nga tri komponente: i) mos-kompenzimi për alokimin e kapacitetit në tri linjat e interkoneksionit që kapin vlerën prej **rreth 225 milion Euro** për periudhën 2004-2019; ii) mos-pagesa e faturave të energjisë në pjesën veriore të Kosovës që deri më sot ka arritur vlerën prej **rreth 204 milion Euro**; dhe iii) të hyrat e humbura që rrjedhin nga mos-shfrytëzimi i linjës së transmisionit 400 kV me Shqipërinë që kapin vlerën prej **rreth 3 milion Euro** për periudhën 2016-2019.

58. Si përmbledhje, që nga viti 1999, Serbia vazhdimisht ka ndërmarrë veprime destruktive në shumë aspekte të ndryshme gjatë procesit të themelimit dhe normalizimit të marrëdhënieve të saj me Kosovën lidhur me sektorin e energjisë. Edhe në kuadër të Dialogut të lehtësuar nga BE edhe nën kujdesin e EnCS në bazë të EnCT, Serbia ka nënshkruar një mori marrëveshjesh mbi energjinë me Kosovën (Marrëveshja e Përkohshme për Shkëmbimin e Energjisë e vitit 2000, Marrëveshja e Përkohshme Teknike e vitit 2001, Marrëveshja e Brukselit e vitit 2013, Marrëveshja mbi Energjinë e vitit 2013, Aranzhimet lidhur me Energjinë të vitit 2013, Raporti mbi Përfundimet i vitit 2015, Marrëveshja Kornizë e vitit 2014, si dhe Marrëveshja ndër-OST e vitit 2014). Përkundër kësaj, siç është shtjelluar më lartë, faktet

dëshmojnë se Serbia në mënyrë konsistente ka shkelur dhe/apo fare nuk i ka zbatuar marrëveshjet e arritura/nënshkruara. Si pasojë, nuk ekziston progres i prekshëm në zbatimin e marrëveshjeve në fjalë dhe negociatat në mes të Kosovës dhe Serbisë në këtë sektor janë shndërruar në një sagë të pafund.

## Rekomandimet

1. Marrëveshje të ndryshme (Marrëveshja e Përkohshme për Shkëmbimin e Energjisë e vitit 2000, Marrëveshja e Përkohshme Teknike e vitit 2001, Marrëveshja e Brukselit e vitit 2013, Marrëveshja mbi Energjinë e vitit 2013, Aranzhimet lidhur me Energjinë të vitit 2013, Raporti mbi Përfundimet i vitit 2015, Marrëveshja Kornizë e vitit 2014, si dhe Marrëveshja ndër-OST e vitit 2014) me qëllimin e njëjtë dhe, në masë të madhe, me përmbajtjen e njëjtë është dashur të arrihen për energjinë, por prapseprap ende nuk ka rezultate të prekshme sa i përket zbatimit të po të njëjtave. Për shkak të kësaj, Kosova nuk duhet të lejojë që negociatat për Energjinë të tranformohen në Sagë të Pafund. Prandaj, Kosova nuk duhet të pranojë vazhdimin e negociatave pa pasur përcaktim të qartë të afatit kohor për përfundim dhe duhet të insistojë të bëj/përcaktojë Aranzhime të detajuara për Energji me tekst specifik dhe të qartë. Duhet të theksohet fuqimisht se Kosova në asnjë rrethanë nuk duhet të pranojë asnjë tekst të marrëveshjes, karakteristikë e të cilit do të ishte çfarëdo **ambiguiteti/dykuptimësie konstruktive**. Përveç kësaj, marrëveshja duhet të jetë e shoqëruar me një plan veprimi të specifikuar qartazi, në të cilin do të jenë qartazi të specifikuara korniza/afatet kohore të zbatimit/realizimit.
2. EnCS, lehtësuesi i Dialogut të Brukselit, si dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që të sigurojnë se Serbia, jo më vonë se gjashtë muaj nga rifillimi i Dialogut të Brukselit, të respektojë Vendimin 2016/02/MC-EnC e Këshillit Ministror të EnC (i elaboruar më sipër në detaje), që do të thotë, se Serbia *“duhet të ndërmarrë të gjitha masat përkatëse për të korrigjuar shkeljen e identifikuar në Nenin 1 dhe të veprojë në përputhje me Ligjin e Komunitetit*

*të Energjisë të dhjetorit 2016. Republika e Serbisë duhet të raportojë në baza të rregullta te Sekretariati dhe te Grupi i Lartë Permanent në lidhje me të gjitha masat e ndërmarra”.*<sup>61</sup>

3. KOSTT dhe EMS duhet të fillojnë negociatat e lehtësuara nga EnCS lidhur me Marrëveshjet e Përkohshme për ITC dhe për Menaxhimin e Kongestionit, duke u bazuar në përpikëri në Marrëveshjen Kornizë në mes të KOSTT dhe EMS. Po ashtu, KOSTT duhet të dorëzojë tek EnCS dhe EMS kërkesën për kompenzimin e të hyrave të cilat EMS i ka realizuar përmes alokimit të kapaciteteve të transmisionit në tri linjat e interkoneksionit të Palëve Kontraktuese fqinje me rrjetin e operuar nga KOSTT për periudhën 2006-2009, gjatë së cilës Kosova ka qenë Palë Kontraktuese e EnCT. Vlera totale, të cilën EMS ia ka borxh KOSTT, duhet të rivlerësohet në mënyrë që ta mbulojë vetëm periudhën 2006-2009. Më pas, një marrëveshje sipas kërkesës së KOSTT duhet të arrihet brenda **një periudhe të shkurtër kohore** nga data e dorëzimit të kërkesës nga ana e KOSTT. Marrëveshja duhet të ngërthejë në vete një plan veprimi lidhur me detajet dhe afatin kohor të pagesave.
  
4. KOSTT dhe EMS duhet të fillojnë negociatat e lehtësuara nga BE në lidhje me kërkesën e KOSTT për kompenzimin e të hyrave të cilat EMS i ka realizuar përmes alokimit të kapaciteteve të transmisionit në tri linjat e interkoneksionit të Palëve Kontraktuese fqinje me rrjetin e operuar nga KOSTT për periudhën 2004-2006, sipas Marrëveshjes së Përkohshme për Shkëmbimin e Energjisë të vitit 2000. Vlera totale, të cilën EMS ia ka borxh KOSTT, duhet të rivlerësohet në mënyrë që ta mbulojë vetëm periudhën 2004-2006. Më pas, një marrëveshje sipas kërkesës së KOSTT duhet të arrihet brenda **një periudhe të shkurtër kohore** nga data e dorëzimit të kërkesës nga ana e KOSTT. Marrëveshja duhet të ngërthejë në vete një plan veprimi lidhur me detajet dhe afatin kohor të pagesave.

---

<sup>61</sup> Po aty.

5. Në rast se Serbia dështon të arrijë marrëveshjet e parapara në Rekomandimet 3 dhe 4, dhe/ose nuk ndërmerr masa për zbatimin e marrëveshjeve kur ato të arrihen, qeveria e Kosovës duhet të dorëzojë ankesat e veta në arbitrazhin ndërkombëtar.
6. Para se të merret ndonjë vendim në arbitrazhin ndërkombëtar, Kosova duhet të pezullojë të gjitha aktivitetet e parapara me Pikën 15 për Shërbimet e Distribuimit sipas Aranzhimeve për energjinë. Do të thotë, Kosova duhet të kushtëzojë zbatimin e Pikës 15 të Aranzhimeve për Energjinë me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të elaboruara në Rekomandimet 3 dhe 4.
7. EnCS, lehtësuesi i Dialogut të Brukselit, d.m.th. BE, si dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që të sigurojnë se Serbia, jo më vonë se **një muaj** nga vazhdimi i Dialogut të Brukselit, të fillojë me zbatimin e Marrëveshjes Kornizë me Kosovën.
8. EnCS, lehtësuesi i Dialogut të Brukselit, d.m.th. BE, si dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që të sigurojnë se Serbia, jo më vonë se **një muaj** nga vazhdimi i Dialogut të Brukselit, të fillojë me zbatimin e Marrëveshjes ndër-OST me Kosovën.
9. Në rast se Serbia dështon ta respektojë në plotëni dhe të zbatojë në plotëni Marrëveshjen Kornizë dhe/ose Marrëveshja ndër-OST me Kosovën, atëherë Kosova duhet të ngritë padi në EnCS.
10. Derisa të mos gjendet një zgjidhje për mosmarrëveshjet në Rekomandimet 7 dhe 8, Kosova duhet të pezullojë të gjitha aktivitetet e parapara në Pikën 15 mbi Shërbimet e Distribuimit të Aranzhimeve për energjinë. Do të thotë, Kosova duhet të kushtëzojë zbatimin e Pikës 15 të Aranzhimeve për Energjinë me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të elaboruara në Rekomandimet 7 dhe 8.

- 11.** Kosova dhe Shqipëria duhet t'i dorëzojnë në arbitrazh ndërkombëtar pretendimet e tyre lidhur me të hyrat e humbura në vlerën prej rreth. 3 milion Euro që rrjedhin nga kushtëzimi i operacionalizimit të linjës 400 kV të interkoneksionit në mes të Kosovës dhe Shqipërisë nga ana e Serbisë me licencimin e ElektroSever.
- 12.** Derisa të mos gjindet një zgjidhje për mosmarrëveshjen në Rekomandimin 11, Kosova duhet të pezullojë të gjitha aktivitetet e parapara në Pikën 15 mbi Shërbimet e Distribuimit të Aranzhimeve për energjinë. Do të thotë, Kosova duhet të kushtëzojë zbatimin e Pikës 15 të Aranzhimeve për Energjinë me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të elaboruara në Rekomandimein 11.
- 13.** Për shkak të shkeljeve të vazhdueshme të EMS, Kosova/KEDS duhet t'i dorëzojë në arbitrazhin ndërkombëtar pretendimet e KEDS lidhur me humbjet që i janë shkaktuar nga mospagesa e faturave të energjisë elektrike nga ana e konsumatorëve në pjesën veriore të Kosovës që deri më sot kanë arritur vlerën prej rreth **204 milion Euro**.
- 14.** Derisa të mos gjindet një zgjidhje për mosmarrëveshjen në Rekomandimin 13, Kosova duhet të pezullojë të gjitha aktivitetet e parapara në Pikën 15 mbi Shërbimet e Distribuimit të Aranzhimeve për energjinë. Do të thotë, Kosova duhet të kushtëzojë zbatimin e Pikës 15 të Aranzhimeve për Energjinë me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të elaboruara në Rekomandimin 13.

